



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
BORDI I ADMINISTRIMIT

V E N D I M

NR. 06, datë 10.01.2020

MIRATIMI I KRITEREVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË PARË
"BACHELOR " DHE CIKLIT TË DYTË "MASTER I SHKENCAVE " PËR VITIN
AKADEMIK 2021 - 2022
DHE
MIRATIMI I KUOTAVE TË PRANIMIT PËR STUDENTËT NË TË TRE CIKLET
E STUDIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë", neni 49, me vendimin nr. 04 të Senatit Akademik me nr. 42 Prot., datë 09. 01. 2020, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e datës 10. 01. 2020,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kriteret e pranimi për studentët në programet e ciklit të parë "Bachelor", për vitin akademik 2021 – 2022 si më poshtë:
 - a. Nota mesatare e përgjithshme arithmetike e shkollës së mesme për të gjitha vitet përfshirë dhe provimet e Maturës Shtetërore në masën 50 %;
 - b. Nota mesatare e gruplëndëve bërthamë (për të gjitha vitet ku shtrihen lëndët), të përzgjedhura nga njësitë kryesore (fakultetet) për çdo program studimi të ciklit të parë në masën 50 % (sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Të miratojë kriteret e pranimi për studentët në programet e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave” për vitin akademik 2021-2022 (sipas shtojcës 2), si më poshtë:
 - a. Nota mesatare e studimeve të ciklit të parë të jetë ≥ 7 (shtatë)
3. Të miratojë kuotat e pranimi për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”; programeve me karakter profesional 2 – vjeçar; programeve të ciklit të dytë “Master”; “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” dhe programeve të ciklit të tretë të studimeve “Doktoraturë në Albanologji”, për vitin akademik 2020 – 2021 sipas shtojcës 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. Merita Isaraj